

Prokuroria dorëzon
aktakuzë ndaj ministres
Hajdari për rastin e
rezervave shtetërore



FAÇE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com




facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

DIPLOMATI I PENSIONUAR AMERIKAN, CHRISTOPHER HILL, KA PËRFUNDUAR
DËSHMINË TREDITORE NË GJYKATËN SPECIALE NË HAGË

HILLI PËRFUNDOI DËSHMINË: THAÇI NUK ISHTE NJË FIGURË VENDIMMARRËSE BRENDA UÇK-së

FAÇE 4



12-11-2025 10:

Në paraqitjen e tij para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Christopher Hill tha se Hashim Thaçi nuk e drejtonte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Sipas tij, UÇK-ja nuk kishte strukturë me organizim hierarkik. Sipas Hillit, Thaçi nuk mund të merrte vendime në emër të UÇK-së gjatë bisedimeve në Rambuje, duke shtuar se ai nuk ishte komandant, por "i duhej t'i pyeste komandantët në Kosovë për të dhënë një qëndrim". Për herë të parë Hilli tha se u takua me Thaçin më 1998

**MEMLI
KRASNIQI
JEP
DORËHEQJE
NGA KRYETARI
I PDK-së** F. 3



**OVL-UÇK PËR
PROTESTËN NË
STRASBURG:
T'I TREGOJMË
EVROPËS SE ISHIM
ÇLIRIMTARË,
JO KRIMINELË** F. 7



**RAMA NJOFTON SE SHQIPËRIA KA
HAPUR TË GJITHË KAPITUJT E
NEGOCIATAVE: ASGJË S'NA NDAL
DREJT BE-së MË 2030** F. 2

**ARIAN TAHIRI: PROCESI I
NUMËRIMIT TË VOTAVE NË
MITROVICË KA NXJERRË NË PAH
SHQETËSIME SERIOZE** F. 6

**OSMANI FALËNDERON TIKÀ-n PËR
NDIHMËN QË I KA DHËNË KOSOVËS
NË VAZHDIMËSI** F. 3

EKONOMI



**GUVERNATORI ISMAILI MERR
PJESË NË CEREMONINË
E 100-VJETORIT TË BANKËS
SË SHQIPËRISË** F. 8

**SEKTORI I NDËRTIMTARISË
SHËNON RRIJJE TË
QËNDRUESHME TË TË HYRAVE** F. 8

SPORT



**KOSOVA NË PRAG TË HISTORISË:
DY NDESHJE, DY VARIACIONE PËR
ËNDRRËN E MADHE E QUAJTUR
KUPA E BOTËS** F. 11

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama njofton se Shqipëria ka hapur të gjithë kapitujt e negociatave: Asgjë s’na ndal drejt BE-së më 2030

TIRANË, 12 NËNTOR - Më 17 nëntor mbahet Konferenca e përbashkët me BE-në për hapjen e grupkapitullit të fundit të negociatave me Bashkimin Evropian. “Shqipëria e arriti të pamendueshmen, të gjithë kapitujt e negociatave të hapur brenda 12 muajsh - rekord absolut në procesin e

integritimeve evropiane. Asgjë nuk na ndal dot drejt majës së Shqipërisë 2030 në BE. Askush nuk na ndal dot drejt objektivit madhor të mbylljes së negociatave brenda 2027”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Ai ka theksuar se përtej vështirësive, pengesave, dëmtimeve të

pashmangshme apo baltës së pandashme, në ngjitjen e kësaj të përpjete historike, nën drejtimin e tij Shqipëria po rritet e forcohet muaj pas muaji. “Me një ekonomi që po rritet; me pensionet që po rriten; me pagën minimale që po rritet; me pagat e tjera që po rriten; me investimet e brendshme e të huaja që po

rriten; me mbështetjen për më të dobët e për të sëmurët me kancer që po rritet; me investimet e brendshme e të huaja që po rriten; pa rritur asnjë taksë dhe duke përmirësuar hap pas hapi punën e institucioneve të shtetit. Shqipëria punon dhe fiton përditë e më shumë respekt”, ka shkruar Rama.



RRËZIMI I AVIONIT USHTARAK ME 20 PASAGJERË, TURQIA: NUK KA ASNJË TË MBIJETUAR

ANKARA, 12 NËNTOR - Të 20 personat që gjendeshin në aeroplanin transportues ushtarak të Turqisë, që u rrëzua në Gjeorgji teksa po kthehej nga Azerbajxhani, kanë vdekur thanë autoritetet turke më 12 nëntor, një ditë pas incidentit. “Bashkëluftëtarët thanë u martirizuan më 11 nëntor 2025, kur aeroplani ynë transportues ushtarak C-130, që ishte nisur nga Azerbajxhani për t’u kthyer në Turqi, u rrëzua pranë kufirit Gjeorgji - Azerbajxhan”, tha ministri turk i Mbrojtjes, Yaser Guler, në “X”, ku publikoi 20 fotografi të të vdekurve.

Rrëzimi i fluturakes ishte konfirmuar më herët nga Ministria e Mbrojtjes e Turqisë dhe ajo e Brendshme e Gjeorgjisë. Autoritetet thanë se aeroplani u rrëzua rreth 5 kilometra larg nga kufiri i Gjeorgjisë me Azerbajxhanin. Autoritetet turke dhe gjeorgjiane raportohet se kanë nisur inspektimet në vendngjarje, në komunën Signagi në qarkun Kaketi të Gjeorgjisë. Shumë udhëheqës botërorë, përfshirë nga Azerbajxhani dhe Gjeorgjia, por edhe sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, kanë shprehur ngushëllime

për këtë ngjarje. Në “X”, Tom Barrack, ambasador amerikan në Stamboll, shprehu solidaritetin e shtetit të tij me Turqinë pas rrëzimit të aeroplanit. Lockheed Martin, kompania amerikane që prodhon avionin C-130 Hercules, shprehu ngushëllimet dhe deklaroi se është e përkushtuar ta ndihmojë Turqinë gjatë hetimit. Disa video të rrëzimit të avionit, të verifikuara nga Radio Evropa e Lirë, kanë qarkulluar në rrjetet sociale, njëra prej të cilave tregon trupin e avionit dhe fragmentet e tij që bien në tokë në pjesë të ndara.



ARMËPUSHIMI NË LINDJEN E MESME VAZHDON MES TENSIONEVE, IZRAELI RIHAP KALIMIN ZIKIM PËR NDIHMA HUMANITARE NË GAZA



JERUSALEM, 12 NËNTOR - Armëpushimi në Lindjen e Mesme po mbahet, edhe pse sulmet e vazhdueshme të forcave izraelite (IDF) në Gaza kanë rritur tensionet në terren. Duke nisur nga sot, kalimi kufitar Zikim, që lidh Izraelin me Gazën veriore, do të rihapet për hyrjen e ndihmave humanitare në Rrip. Lajmi u konfirmua nga COGAT, organ i Ministrisë së Mbrojtjes izraelite që merret me çështjet civile në territoret palestineze. Ministri italian i Mbrojtjes, Guido Crosetto, ka komentuar situatën duke theksuar rolin jetik të misionit UNIFIL në ruajtjen e

stabilitetit rajonal. “Misioni UNIFIL është një shtyllë themelore për sigurinë dhe stabilitetin në gjithë Lindjen e Mesme. Për këtë arsye duhet vlerësuar me kujdes mënyra dhe koha e një tërheqjeje të mundshme, ose alternativisht garantimi i një pranije të re dhe më të fortë ndërkombëtare që ta vazhdojë trashëgiminë e tij”, deklaroi ai. Krahës, zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm italian, Antonio Tajani, njoftoi në rrjetin X se kamionët italianë tashmë kanë hyrë në Gaza për të ofruar

ndihma për civilët. “Italia do të vazhdojë të ndihmojë në çdo mënyrë të mundshme ata që ende vuajnë”, shkroi ai. Në Izrael, ndërkohë, skena politike ka marrë një kthesë të rëndësishme. Knesseti votoi për herë të parë pro vendosjes së dënimit me vdekje për terroristët, një hap që pritet të ndezë debate të forta brenda dhe jashtë vendit, në një moment kur rajoni ndodhet nën presion të madh diplomatik dhe humanitar. Situata mbetet e tensionuar, ndërsa komuniteti ndërkombëtar ndjek me shqetësim zhvillimet e ditëve në vijim.

Presidenti kolumbian pezullon shkëmbimin e informacioneve të inteligjencës me ShBA-në

BOGOTA, 12 NËNTOR - Presidenti kolumbian Gustavo Petro ka njoftuar se kishte urdhëruar forcat e sigurisë së vendit të tij ta pezullonin shkëmbimin e informacionit me Shtetet e Bashkuara derisa të mbarojnë sulmet ajrore kundër anijeve që Uashingtoni thotë se transportojnë drogë në Karaibe

dhe Paqësor. “Lufta kundër drogës duhet t’i nënshtrohet mbrojtjes së të drejtave të popujve të Karaibeve”, deklaroi Petro në platformën “X”, duke iu referuar bashkëpunimit të gjatë dhe shpesh të tensionuar mes Kolumbisë dhe ShBA-së në luftën kundër trafikimit të

narkotikëve. Ky vendim vjen në një moment tensionesh të rritura, pasi Bogota ka kritikuar qasjen ushtarake të Uashingtonit, duke kërkuar një strategji më “njerëzore dhe efektive” që, sipas Petros, “të mos ndëshkojë popujt, por rrënjët e problemit”.



MEMLI KRASNIQI JEP DORËHEQJE NGA KRYETARI I PDK-së

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Në një konferencë për medie në selinë qendrore të Partisë Demokratike të Kosovës, kryetari Memli Krasniqi ka njoftuar për dorëheqjen nga drejtimi i partisë, duke e cilësuar këtë vendim "hap reflektimi dhe përgjegjësie për krijimin e një momentum të ri për PDK-në". Krasniqi ka falënderuar qytetarët e Kosovës, anëtarët dhe mbështetësit e Partisë Demokratike të Kosovës për përkrahjen dhe besimin e dhënë gjatë më shumë se dy dekadave të angazhimit politik. "Në rini njeriu nuk e di gjithmonë se çfarë do të bëhet, por shumë herë e di në çfarë do të besojë. Dhe unë, që nga rinia, e kam ditur se dua të besoj në Kosovën

e ëndrrave të mia", tha ai. Krasniqi theksoi se udhëtimi i tij politik ka qenë i lidhur ngushtë me PDK-në, që nga viti 2004 kur iu bashkua si aktivist i ri, deri në postin e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës. "Ajo që nisi si një angazhim rinor e idealist, u kthye në udhëtimin më të rëndësishëm të jetës sime. Mbi njëzet vjet angazhim me PDK-në më kanë dhënë nderin të punoj për shtetin tim dhe qytetarët e mi - nga kryetar i Rinisë Demokratike deri te kryetar i Partisë Demokratike. Mbi të gjitha, kam pasur nderin e pakrahasueshëm ta nënshkruaj Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës". Duke reflektuar për periudhën

katërvjeçare të udhëheqjes së tij, Krasniqi vlerësoi se PDK-ja është forcuar dhe rritur ndjeshëm në skenën politike, megjithatë theksoi se çdo organizatë e madhe politike ka nevojë për ripërtëritje. "Një parti që beson në zhvillim, duhet të besojë edhe në ripërtëritje. Një lidhshmëri që kërkon ndryshim për Kosovën, duhet të ketë guximin të krijojë hapësirë për ndryshim brenda vetes. Prandaj, kam vendosur të jap dorëheqje nga pozita e kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës", tha ai. Ai theksoi se ky vendim nuk lidhet me ndonjë zhvillim të fundit politik, por me nevojën për t'i dhënë partisë "një frymë të re dhe një mundësi të re për të ardhmen".



OVL-UÇK PËR PROTESTËN NË STRASBURG: T'I TREGOJMË EVROPËS SE ISHIM ÇLIRIMTARË, JO KRIMINELË

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Përfaqësuesi i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Evropë, Fatmir Koci, ka bërë një thirrje për pjesëmarrje masive në protestën që do të mbahet më 16 nëntor në Strasburg, Francë, para Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së që po gjykohej në Hagë. "Thirrje gjithëpopullore për pjesëmarrje sa më të madhe në Strasburg, Francë, për t'i dënuar padrejtësitë që po u bëhen krerëve të UÇK-së dhe luftës sonë të shenjtë. Bashkohuni, shqiptarë, kudo që jeni, që të dërgojmë një mesazh para Asamblesë Parlamentare të Evropës: ne ishim çlirimtarë, jo agresorë, jo kriminelë. T'i tregojmë botës se ky proces është i fabrikuar nga Serbia dhe



Rusia, sepse ne luftuam për lirinë tonë", tha Koci për "Albanian Post". Protesta e Strasburgut, e organizuar nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVL-UÇK), vjen pas një sërë

tubimesh që janë mbajtur në Prishtinë, Hagë dhe Tiranë, ku mijëra qytetarë kanë kërkuar lirimin e ish-krerëve të UÇK-së: Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, kishte bërë me dije se protesta në Strasburg do të mbahet më 16 nëntor në orën 13:00. "Kjo protestë do të jetë zëri i drejtësisë për çlirimtarët tanë. Ne nuk do të ndalemi derisa të dëgjohet e vërteta jonë në zemër të Evropës", kishte thënë Gucati në një konferencë për medie. Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka reaguar rreth protestës që do të mbahet të dielën, më 16 nëntor në Strasburg të Francës. Ai përmes në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se është gjithmonë në përkrahje të luftës çlirimtare. "Përfundim UÇK! Gjithmonë në përkrahje të luftës së drejtë çlirimtare!", ka shkruar Haradinaj. Protestat e mëparshme janë

mbajtur në 5 nëntor para zyrave të EULEX-it në Prishtinë, dhe më 17 tetor në Tiranë, ku me moton "Liri për çlirimtarët" u mbledhën mijëra qytetarë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora shqiptare. Ish-udhëheqësit e UÇK-së ndodhen në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020, nën akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në prill 2023, ndërsa aktualisht po vazhdon me dëshmitë e mbrojtjes. Përfaqësuesit e OVL-UÇK-së dhe organizatat e tjera të dala nga lufta kanë theksuar se këto gjykime përbëjnë një padrejtësi historike dhe se protestat synojnë të dërgojnë një mesazh uniteti mbarëkombëtar për mbrojtjen e luftës çlirimtare dhe dinjitetit të saj.

Osmani falënderon TİKA-n për ndihmën që i ka dhënë Kosovës në vazhdimësi

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TİKA), Abdullah Eren, me të cilin ka diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Turqisë në fusha të ndryshme zhvillimore. Presidentja Osmani shprehu mirënjohje të thellë për kontributin e TİKA-s në zhvillimin e Kosovës për më shumë se dy dekada, duke

theksuar se projektet e kësaj agjencie kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në përmirësimin e infrastrukturës kulturore, arsimit dhe shëndetësisë në vend, duke falënderuar posaçërisht për mbështetjen në ndërtimin e Qendrës për Fëmijë me sindromën Down dhe Autizëm në Prishtinë.

Në këtë kontekst, presidentja Osmani e vlerësoi Turqinë si mike dhe partnere strategjike të Kosovës, një shtet që ka qëndruar pranë popullit tonë në çdo fazë, nga periudha pas luftës e deri më sot. Ajo theksoi se miqësia ndërmjet dy



popujve është e qëndrueshme dhe e ndërtuar mbi respekt, ndihmë reciproke dhe vlera të përbashkëta. Presidentja Osmani e përgëzoi Abdullah Eren për emërimin e tij në krye të TİKA-s, duke i

uruar suksese në detyrën e re dhe shprehur dëshirën për një vazhdim të frytshëm të bashkëpunimit dypalësh në të gjitha fushat me interes të ndërsjellë. Gjatë takimit presidentja

Osmani falënderoi TİKA-n për ndihmën humanitare dhe infrastrukturore të dhënë menjëherë pas luftës, kur Kosova po rindërtohej nga shkatërrimi, si dhe për restaurimin e objekteve me vlerë historike, që kontribuojnë në ruajtjen e trashëgimisë shumëkulturore të vendit.

Në përmbyllje, presidentja theksoi rëndësinë e mbështetjes së iniciativave që lidhen me fëmijët me nevoja të veçanta, ata pa përkujdes prindëror, grupet e marginalizuara dhe ata që kanë nevojë për përkrahje.



DIPLOMATI I PENSIONUAR AMERIKAN, CHRISTOPHER HILL, KA PËRFUNDUAR
DËSHMINË TREDITORE NË GJYKATËN SPECIALE NË HAGË

HILLI PËRFUNDOI DËSHMINË: THAÇI NUK ISHTE NJË FIGURË VENDIMMARRËSE BRENDË UÇK-së

Në paraqitjen e tij para Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë, Christopher Hill tha se Hashim Thaçi nuk e drejtonte Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Sipas tij, UÇK-ja nuk kishte strukturë me organizim hierarkik. Sipas Hillit, Thaçi nuk mund të merrte vendime në emër të UÇK-së gjatë bisedimeve në Rambuje, duke shtuar se ai nuk ishte komandant, por “i duhej t’i pyeste komandantët në Kosovë për të dhënë një qëndrim”. Për herë të parë Hilli tha se u takua me Thaçin më 1998

Hagë, 12 nëntor - Diplomati i pensionuar amerikan Christopher Hill ka përfunduar të mërkurën dëshminë treditore para Gjykatës Speciale në Hagë në cilësinë e dëshmitarit mbrojtës të Hashim Thaçit. “Ishte një përvojë e veçantë”, tha Hilli në përfundimin e dëshmisë së tij. Gjatë dëshmisë treditore, Hilli foli për rolin e Thaçit në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe në negociatat në Rambuje. Ai tha se përshtypja e tij ishte

që Thaçi nuk ishte një figurë vendimmarrëse brenda UÇK-së, pasi kujtoi se gjatë negociatave në Rambuje atij i duhej të konsultohet paraprakisht me të tjerët brenda UÇK-së dhe nuk mund të merrte vendime krye më vete. Në ditën e tretë të dëshmisë, trupi gjyqësor e pyeti Hillin nëse UÇK-ja ishte e strukturuar dhe ai përsëriti qëndrimin se nuk kishte një hierarki të mirëfilltë. Megjithatë, ai tha se UÇK-ja

tentonte të binde ShBA-në se ishte një organizatë dhe ushtri e strukturuar mirë. Gjykatësit e pyetën edhe për takimet e tij me udhëheqësin e atëhershëm serb, Slobodan Millosheviq. Hilli tha se Millosheviqi shqetësohej që ShBA-ja po anonte nga UÇK-ja dhe po linte anash LDK-në. Po ashtu, nënshkrimi i marrëveshjes së Rambujesë, sipas tij, hodhi poshtë pretendimin e Millosheviqit se shqiptarët nuk mund të bëheshin bashkë e të pajtoheshin për ndonjë gjë. Hilli përsëriti qëndrimin e shprehur edhe në ditët paraprake të dëshmimit, se nuk mendonte se Thaçi ishte një nga themeluesit e UÇK-së, nuk e dinte kush ishte përgjegjës në UÇK dhe kush i lëshonte komunikatat. Diplomati amerikan në pension edhe në ditën e tretë të dëshmisë përsëriti se nuk kishte informacione se Thaçi ishte përfshirë në ndonjë aktivitet të paligjshëm të

shkeljes të të drejtave të njeriut.

“Thaçi nuk ishte vendimmarrës”

I fundit nga trupi gjyqësor që i parashtrroi pyetje Hillit ishte gjykatësi Christoph Barthe. Ai kërkoi nga Hilli të shpjegonte se si ishte e mundur që Thaçi, pasi Hilli tha se nuk e dinte nëse ishte themelues i UÇK-së, të merrte një rol kaq të madh në Rambuje dhe më pas në Qeverinë e përkohshme të Kosovës. Hilli tha se për këtë s’ka shpjegim, por mendon se Thaçi s’ishte vendimmarrës. “S’kam shpjegim, por kam mendime. Një nga to është, mbase, se nuk ishte aq i fuqishëm sa shikohej nga jashtë. Sepse çdo vendim që merrte ai vinte si rezultat i shumë konsultimeve pararendëse. Përshtypja ime është që ai ishte një bashkëbisedues i besueshëm, por nuk ishte vendimmarrës. Kjo përshtypje bënte kuptim

kur ai na tha se nuk mund të pajtohej lidhur me atë që ishte bërë në Rambuje, dhe shembull na tha që nëse pajtohej pa u konsultuar, kur të kthehej do ta vrisnin. Një vendimmarrës nuk e bën një koment të kësaj natyre. Unë e kam kuptuar se ai ishte i besuar për të mbledhur informacione. Atij i besohej t’i parashtronte argumentet e UÇK-së, por nuk ishte i besuar në vendimarrje, nuk i ishte lënë në dorë vendimarrja”, tha Hilli.

Hilli pyetet për madhësinë e UÇK-së

Gjykatësi Geynor lexoi një dokument, ku një burim i mbrojtur kishte pretenduar se UÇK-ja kishte 30 mijë ushtarë dhe po aq armë. Në dokumentin e shkruar nga Burns, tha gjykatësi, ShBA-ja vlerësoi se UÇK-ja kishte 22 mijë anëtarë, kishte zona dhe secila prej tyre kishte pesë brigada dhe pesë batalione me

140-150 persona. Hilli tha se nuk e di se si është mbledhur ky informacion dhe nuk i kujtohej nëse intelijenca amerikane e kishte konfirmuar një shifër të tillë. Por, tha se për të nuk ishte e rëndësishme se sa brigada e batalione kishte UÇK-ja. “Megjithatë, lidhur me vazhdimin e negociatave, situata nuk ndryshonte për mua, sepse neve na duhej UÇK-ja si pjesë e negociatave pavarësisht se sa brigada kishte. Ne donim që të mos e linin mënjatë LDK-në, se ajo nuk kishte rëndësi, siç thoshin disa”, tha Hilli. Sipas këtyre shifrave, Hilli tha se UÇK-ja del të ketë qenë një forcë e madhe, “por kjo nuk më interesonte” pasi, sipas tij, për negociata ai dëshironte që të kishte një grup përfshirës, “nga UÇK-ja, LDK-ja dhe të pavarurit dhe për të gjetur një zgjidhje”.

Hilli: Përshtypja ime është që Thaçi nuk mund t’i lëvizte gjërat brenda UÇK-së

Gjykatësi Gaynor e pyeti Hillin nëse pajtohej që UÇK-ja mund të përshkruhej si një lëvizje çlirimtare e armatosur. Ai tha se po, megjithatë shtoi se UÇK-ja kishte grupe që vepronin “sipas kokës së tyre”. Kur u pyet të bënte dallimin mes një

udhëheqësi politik dhe ushtarak në kuadër të një lëvizjeje të tillë, Hilli tha se Thaçi nuk i dukej se mund të “lëvizte gjërat brenda UÇK-së”. “Udhëheqësi politik është një person që luan një rol të ministrit të Jashtëm, nëse mund ta them kështu, dhe nuk është përgjegjës për punët e brendshme. Përshtypja ime është që nëse shikoni historikun e Thaçit, formimin e tij, nuk ka asgjë që sugjeron se mund t’i lëvizte gjërat brenda UÇK-së. Por, në pikëpamjen e jashtme ai e kuptonte se si funksiononte bota dhe e kuptonte që është e rëndësishme që ShBA-ja të ishte në anën e tyre”, tha ai.

Hilli: UÇK-ja dëshironte të tregonte se ishte përgjegjëse për Kosovën

Gjykatësi Fergal Gaynor e pyeti Hillin për një kabllogram të 3 nëntorit 1998, të shkruar nga ish-diplomati amerikan Sean Burns, ku jepeshin hollësi për strukturën e UÇK-së, përfshirë Drejtorinë Politike dhe Shtabin e Përgjithshëm. Hilli tha se ai nuk pajtohej me këtë përshkrim të Burnsit dhe se i dukej i ekzagjeruar. Ai tha se ka gjasa që këto informacione Burnsi i ka marrë nga burimet e UÇK-së. “Sean

ishte më i prirë se unë të besonte se ekzistonte një objekt që kishte linjën hierarkike të komunikimit, që njihej ndryshe si UÇK-ja dhe termi komisar është term perëndimor. Megjithatë, ai mendonte se ekzistonte një strukturë e mirorganizuar. Unë nuk ndaja të njëjtin mendim. Unë e respektoj shumë Seanin, por mendoj se kjo ishte një orvatje për të përshkruar një organizatë dhe mendoj se e kishte ekzagjeruar pak përshkrimin e kësaj organizate”, tha Hilli. Ai tha se këto informacione nuk synonin të thoshin të vërtetën, por të kishin ndikim. “Ishte përpjekje për të na bindur ne dhe për të na thënë se kjo është një organizatë dhe një ushtri e mirorganizuar. Unë nuk e shihja njësoj si ai. Dhe të jem i sinqertë, nuk pajtohem me këtë deklaratë dhe ia kam thënë”, tha Hilli. Sipas Hillit, ata nuk kishin parë një organizatë të strukturuar mirë sipas standardeve perëndimore. “UÇK-ja donte të tregonte se ne jemi përgjegjës për Kosovën, jo LDK-ja. Nën dy, nëse na duhen aleatë në një betejë kandër Serbisë, atëherë duhet të themi se kemi një ushtri të mirë në terren dhe emri i saj është UÇK. Dhe meqë kemi ushtri dhe kontroll politike, e vetmja që mungonte ishte forca ajrore.



Shpesh na thoshin se duhet të përfshiheshim në fushatën bombarduese. Kjo është shkruar për të pasur ndikim, jo për të informuar”, tha Hilli.

Hilli: Isha i kënaqur që i gjithë delegacioni i Kosovës u pajtua me marrëveshjen në Rambuje

I dërguari i ShBA-së për Kosovën në kohën e luftës, Christopher Hill, u pyet për procesin e Rambujesë. Ai tha se gjatë bisedimeve ai ishte optimist se Rambujeja do të funksiononte. Ai tha se morën sinjale nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së se e përkrahnin marrëveshjen, por tregoi se kishin shqetësime se çfarë do të ndodhte në Serbi, pasi nuk e nënshkroi marrëveshjen. “Shqiptarët u kthyen në Kosovë për të gjetur paqe, pas Rambujesë serbët u kthyen në Serbi për t’u përgatitur për luftë”, tha ai. Kur u pyet se kush e nënshkroi marrëveshjen, Hilli tha se nuk i kujtohej. “Ajo çfarë më kujtohet është se i gjithë delegacioni i Kosovës ishte dakord për marrëveshjen dhe ishin pozitivë për nënshkrimin në Paris. Isha shumë i kënaqur, që ata s’kishin pasur qasje të njëjtë, në atë moment ishin në një mendje, ishin bashkë”, tha ai. Hilli u pyet nëse Italia kishte ngurruar për marrëveshjen, pasi Serbia nuk e kishte nënshkruar. Hilli tha se marrëveshja ishte mesazh për serbët se “kjo do të ndodhë dhe është mirë që të bëheni pjesë e procesit”. Sipas tij, ky proces hodhi poshtë idenë e Slobodan Millosheviqit që “shqiptarët nuk pajtohen për asgjë”. “Ky ishte një mesazh i kundërt me atë se çfarë po thoshte Millosheviqi. Ne po i thoshim Millosheviqit që e kishe gabim, se e arritëm marrëveshjen, por ti do të bësh mirë që të mendosh se cila do të jetë lëvizja e radhës e Serbisë”, u shpreh Hilli.

Hilli: Në aspektin e bashkëpunimit, Demaçi ishte person i vështirë

Trupi gjykues e pyeti Hillin për Adem Demaçin. Sipas diplomatit amerikan në pension, Demaçi ishte një person që kishte qëndrime të ashpra ndaj Serbisë dhe “një lloj mllefi” pasi kishte qenë i burgosur. “Ai nuk ishte një person me të cilin mund të bashkëpunojë, të punojë në një dokument. Kishte opinione shumë të forta. Por, në aspektin e bashkëpunimit ishte i vështirë dhe ne nuk ishim të interesuar ta promovonim atë si person”, tha Hilli. I pyetur nëse ishte kundër që Demaçi të bëhej pjesë e ekipit

për në Rambuje, Hilli tha se nuk ishte në favor që ai të merrte rol udhëheqës. “Në mungesë të komandës, kishte luftë mes njerëzve për pozicione. Ai mendonte se kishte vuajtur më shumë dhe mendonte se i takonte një rol udhëheqës. Unë nuk doja që ai të ishte personi që ta konsolidonte këtë rol. Ishte shqetësim”, tha ai.

Hilli: S’kam dëgjuar që Drejtoria Politike ishte pjesë e Shtabit të Përgjithshëm

Christopher Hill tha se s’kishte dëgjuar që Drejtoria Politike ishte pjesë e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së apo “që drejtonte ndonjë gjë”. “Supozimi ynë ishte që Shtabi i Përgjithshëm ishte më shumë organ ushtarak dhe përbëhej nga komandantë lokalë që ishin bashkuar në një moment dhe Drejtoria Politike ishte më shumë organi që merrej me botën e jashtme”, tha ai. Sipas tij, personat brenda Drejtorisë Politike po tentonin ta konsolidonin pozicionin e tyre, por nuk kishte një strukturë komanduese. “Ideja që drejtoria kishte ndonjë rol brenda shtabit ishte diçka që personat brenda drejtorisë, përfshirë Demaçin, ishin përpjekje për të treguar se ne jemi përgjegjës”, tha ai. “Dhe fakti që s’mund të gjenim një person që fliste në emër të të tjerëve, i konfirmoi dyshimet tona”. Ai tha se shkoï në Shqipëri për t’u takuar me Xhavit Halitin pasi disa persona në qeverinë amerikane besonin se ai ishte personi përgjegjës, duke shtuar se edhe udhëtimet brenda Kosovës u bënë me qëllim që të gjendej personi që mund të fliste në emër të UÇK-së.

Hilli: S’e dinim kush i lëshonte komunikatat e UÇK-së

Hilli tha se nuk e dinte se kush i lëshonte komunikatat e UÇK-së, ku përmendeshin edhe emra të udhëheqësve, andaj tha se nuk e dinte nëse kjo organizatë kishte një strukturë. “Nuk mund t’i përdornim komunikatat për të përcaktuar një strukturë bazë hierarkike”, tha ai. Kur u pyet për Drejtorinë Politike të UÇK-së, Hilli tha se kishte mësuar që Thaçi ishte pjesë e këtij organi, por nuk e dinte se kush tjetër ishte pjesë e saj. “Kishte shumë persona që nuk ishin në qeveri apo në agjenci të tjera amerikane që përpiqeshin të mësonin se kush e udhëhiqte UÇK. Kur dilnin emra të rinj ne interesoheshim. Një prej këtyre emrave ishte drejtori publik. Por, ne duhej ta komunikonim këtë person”, tha ai. (rel)

Arian Tahiri: Procesi i numërimit të votave në Mitrovicë ka nxjerrë në pah shqetësime serioze

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kandidati i PDK-së për kryetar të Mitrovicës, Arian Tahiri, ka shkruar në "Facebook" se procesi i numërimit të votave në Mitrovicë ka nxjerrë në pah shqetësime serioze. "Të dashur qytetarë, procesi i numërimit të votave ka nxjerrë në pah shqetësime serioze, që

kërkojnë verifikim të plotë dhe trajtim të drejtë ligjor. Kjo nuk është më çështje vetëm e rezultatit, por edhe e drejtësisë dhe parimeve demokratike. Unë dhe ekipi im jemi të përkushtuar ta mbrojmë integritetin e procesit zgjedhor dhe vullnetin e qytetarëve të Mitrovicës. Nga institucionet

përgjegjëse, po ashtu, kërkojmë transparencë dhe ndershmëri, sepse demokracia jonë nuk mund të ndërtohet mbi parregullsi dhe manipulime zgjedhore. Mitrovica meriton drejtësi dhe përkushtimi ynë është i pakompromis për ta siguruar atë", ka shkruar Tahiri.



RRJEDH AFATI PËR FORMIMIN E QEVERISË, HOTI THOTË SE LV-ja DY HERË E MORI MANDATIN PA ASNJË BAZË

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Pas dështimit të formimit të qeverisë, Lëvizja Vetëvendosje (LV) ndryshoi mandatarin, duke zëvendësuar Albin Kurtin me Glauk Konjufcën. Më 4 tetor presidentja e vendit, Vjosa Osmani, i ka dhënë mandatarin për formimin e qeverisë së re kandidatit të propozuar nga LV-ja, Glauk Konjufcës. Ndërkohë që afati për formimin e qeverisë ka nisur të rrjedhë, nga LV-ja nuk ka pasur ende asnjë deklaratë nëse kanë arritur ta krijojnë shumicën për ta votuar Konjufcën si kryeministër. Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, shpreh skepticizëm sa i përket formimit të qeverisë nga LV-ja. Për "Telegrafi"-n ai ka deklaruar se që nga muaji prill është ditur se nuk po mund të formohet shumica. "Nuk shoh asnjë mundësi për formimin e qeverisë. Këta e dinë edhe këta që dy herë e morën

mandatin pa asnjë bazë. Nga prilli dhe maji është ditur se nuk po mund të formohet shumica. Pavarësisht kësaj, e mbajtën vendin në bllokadë duke mos hapur mundësinë për të shkuar në zgjedhje", deklaroi ai. Po ashtu, as nga PDK-ja dhe nga AAK-ja nuk ka pasur ndonjë përgjigje se si do të jetë qëndrimi i tyre rreth formimit të qeverisë. Ndërsa mandatarin për kryeministër të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se nuk e di saktë se sa i ka gjasat për t'u bërë kryeministër. Ai ka deklaruar se nëse Kosova do të ketë një qeveri të re apo do të shkohet në zgjedhje të parakohshme, nuk varet tërësisht nga Lëvizja Vetëvendosje, pasi nevojiten edhe votat e partive të ish-opozitës. "Ne e kemi në dorë për ta propozuar mandatarin e dytë, me këtë rast unë u propozova, edhe presidentja më mandatoi



kandidat. Kabineti im dhe unë si kryeministër do të dalim në seancë kur ne do të vendosim

ditën e saktë. A do të votohem apo jo, më së shumti në dorë e kanë deputetët e partive të tjera. Ju e

dini se deri tani në këtë kompozicion tonë të numrave të mazhorancës nuk kanë qenë më shumë sesa 56-57", tha ai. Para disa ditësh kryeministri në detyrë Albin Kurti ka deklaruar se për vendin është më mirë të votohet qeveria. "Meqenëse nuk i mora 61 votat e nevojshme, dhamë propozimin (Glauk Konjufcën mandatar për formimin e qeverisë) pa vonesë, me këtë do të merremi menjëherë pas balotazhit, dhe opozita e ka në dorë ta zgjedhë rrugën e mëtutjeshme, ose Kurti 2.5 drejt zgjedhjeve në dhjetor, ose Konjufca 1 drejt zgjedhjeve në prill, cilado prej tyre për ne është e pranueshme, por le të bashkëpunojmë e të ecim përpara", ka pohuar Kurti. Që nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare në Kosovë, më 9 shkurt, vendi ka mbetur pa formimin e institucioneve të reja.

AGK-ja: GJUHË E PAPRANUESHME SULMUESE E DONIKA GËRVALLËS NDAJ T7 DHE LEONARD KËRQUKUT



Prishtinë, 12 nëntor - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) e vlerëson të papranueshëm dhe të padinjitetshëm për postin që mban, sulmin me gjuhë të ulët të zëvendëskryeministres në detyrë, Donika Gërvalla, ndaj "Televizionit 7" dhe gazetarit Leonard Kërquki, autor i emisionit "Pressing". AGK-ja dënon ashpër një fjalor të tillë nga një zyrtare e lartë e shtetit, që synon ta minojë punën e televizionit dhe gazetarit, në një

medium ku ajo vetë ka dhënë intervistë. AGK-ja i fton zyrtarët e qeverisë në detyrë dhe përfaqësuesit e partisë shumicë të mandatit të kaluar që të tregohen të përmbytur në reagimet e tyre publike, duke mos vazhduar me sulme frontale ndaj medieve. AGK-ja dënon çdo formë dhune dhe mungesë tolerance që manifestohet në transmetimet e drejtpërdrejta të debateve politike. "Televizion rrugaç.

Moderator rrugaç. 'Analist' mercenar rrugaç. Por me prof. Nezir Krakin kot e keni. As nuk mateni e as nuk ia dilni dot. Në mes të llumit tuaj shkëlqen dija dhe dinjiteti i tij. Marre ju kostë!", ka shkruar Gërvalla në "Facebook", si reagim ndaj incidentit mes deputetit Nezik Kraki nga partia Guxo dhe gazetarit Parim Olluri, i cili për pak sa nuk përfundoi në përleshje fizike në emisionin "Pressing".

Elshani: Do ta çojmë procesin në Mitrovicë deri në rivotim

Prishtinë, 12 nëntor - Procesi i verifikimit të fletëvotimeve në Qendrën Komunale të Numërimit në Mitrovicë ka përfunduar, ndërsa nga Partia Demokratike e Kosovës kanë paralajmëruar se do ta çojnë çështjen deri në rivotim pas konstatimit të disa parregullsive. Anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga radhët e PDK-së, Arianit Elshani, ka bërë me dije përmes një postimi në rrjetet sociale se ekipet e

partisë, bashkë me vëzhguesit në terren, kanë evidentuar "çdo rast të dyshimtë" që lidhet me përzierjen e fletëvotimeve. "Që nga momenti kur u identifikuan fletëvotime me numra serikë që i përkasin vendvotimeve të tjera, jemi angazhuar me të gjitha ekipet e numërimit dhe me vëzhguesit e PDK-së në Mitrovicë për të evidentuar çdo rast të dyshimtë", ka shkruar ai. Sipas tij, është "jashtëzakonisht shqetësuese" që ky fenomen

është vërejtur në disa vendvotime, madje edhe në raste kur fletëvotime nga një shkollë janë gjetur në shkolla të tjera. "Të gjitha këto dëshmi dhe fakte të mbledhura do t'i adresojmë në PZAP, dhe këtë proces do ta çojmë deri në fund, deri në rivotim!", ka shtuar ai. Ai ka përgëzuar ekipin e PDK-së në Mitrovicë për punën e bërë dhe ka theksuar se synimi kryesor është "mbrojtja e vullnetit të qytetarëve dhe integritetit të zgjedhjeve".



PROKURORIA DORËZON AKTAKUZË NDAJ MINISTRES HAJDARI PËR RASTIN E REZERVAVE SHETËRORE

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Prokuroria Speciale e Kosovës e ka dorëzuar në Gjykatën Themelore një aktakuzë ndaj ministres në detyrë të Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, si dhe ndaj tre të tjerëve, për keqpërdorimin e dyshuar të rezervave shtetërore.

Prokuroria tha se Hajdari, dhe dy zyrtarët Irfan Lipovica dhe Hafiz Gara, dyshohen se bashkëkryerje i kanë keqpërdorur detyrat zyrtare me qëllim që të përfitonin pasuri për persona të tjerë dhe i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës gjatë muajve shkurt dhe mars 2022.

Buxheti i shtetit ka pësuar një dëm prej rreth tre milionë eurove si pasojë e veprimeve të tyre, tha Prokuroria në një njoftim. Ata dyshohet se asokohe kishin blerë një sasi vaji dhe një sasi gruri jashtë vendit, që nuk kishin arritur kurrë në Kosovë.

Që të tre akuzohen për kryerjen e veprave penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare.

Ndërsa i akuzuari i katërt, R. M., dyshohet për ndihmën në kryerjen e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar. Hajdari, Lipovica dhe Gara akuzohen gjithashtu se, pa autorizim, kanë zbuluar fshehtësinë zyrtare. “Edhe pse kanë qenë në dijeni se vendndodhja e rezervave shtetërore përbën sekret shtetëror, sipas Ligjit për

Rezervat Shtetërore të Mallrave, ata me dashje ia kanë vënë në dispozicion këtë informacion të pandehurit R. M.”, thuhet në njoftim.

Sipas aktakuzës, R. M. më pas u kishte krijuar kushte të tjerëve për kryerjen e veprës penale, duke ndërmjetësuar dhe negociuar drejtpërdrejt, si dhe duke propozuar e rekomanduar përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë në emër të rezervave shtetërore.

Gara, drejtor i Departamentit të Rezervave Shtetërore, dhe Lipovica, drejtor i Departamentit për Integritet Evropian, ishin arrestuar më 2023 për këtë rast. Më herët të martën, Hajdari tha se ishte njoftuar nga avokati i vet për aktakuzën. “Sapo ta kem pranuar të plotë dokumentin e aktakuzës do të deklarohem më gjerësisht për medie”, shkroi Hajdari.

Hajdari, megjithatë, tha se ndihet “krenare për punën që kam bërë si ministre në kohën më të vështirë - sigurimin e rezervës shtetërore të mallrave, me produktet esenciale për jetesë, në kohën kur ishim të pambrojtur, gjatë muajve shkurt dhe mars 2022”.

Albulena Haxhiu, nënkryetare e Kuvendit të Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë Albin Kurti, e mbrojti Hajdarin në një postim në “Facebook”, duke thënë se ajo “nuk është e korruptuar, as nuk ka keqpërdorur ndonjëherë detyrën e saj zyrtare”. Ajo e quajti aktakuzën të “motivuar



politikisht, pa asnjë bazë reale dhe dukshëm e qëllimshme”.

Haxhiu, e cila ishte ministre e Drejtësisë në mandatin e kaluar katërvjeçar të Kurtit, tha se Hajdari “ka bërë gjithçka që ka qenë në dorën e saj për ta mbrojtur interesin e vendit dhe për të siguruar që Kosova të ketë rezerva shtetërore, ndryshe nga qeveritë e kaluara të cilat kishin lënë vendin pa rezerva”.

Hajdari ishte marrë në pyetje disa herë nga Prokuroria Speciale si e dyshuar për keqpërdorimin e rezervave shtetërore, por ishte mbrojtur në heshtje. Si dëshmitar për këtë rast është thirrur edhe kryeministri në detyrë, Albin Kurti, por deri më tani nuk ka

pranuar të shkojë në Prokurorinë Speciale, duke ngulur këmbë ta japë dëshminë në Kryeministri.

Rasti i rezervave shtetërore

Më 2023 tre persona u arrestuan për rastin e rezervave shtetërore. Në mesin e tyre kanë qenë edhe punonjës të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), që udhëhiqet nga Rozeta Hajdari, e cila, gjatë paraqitjes për dëshmi në Prokurorinë Speciale, ka zgjedhur të mbrohet në heshtje. Në këtë Ministri, më 2023, u

kryen bastisje pas publikimit të audio-incizimeve nga portali “Nacionale”, ku ishte pretenduar se një sasi vaji, e blerë në Poloni, dhe një sasi gruri, e blerë në Turqi, nuk kishin arritur kurrë.

Hajdari ka thënë se blerjet për rezerva shtetërore ishin bërë në përputhje me ligjin, por nuk ka dhënë më shumë hollësi, meqë informacionet për to janë sekrete shtetërore. Ajo e ka akuzuar policinë se gjatë bastisjeve ka marrë në cilësinë e provave dokumente të klasifikuara si sekrete shtetërore. Kurti i ka dalë në mbrojtje Hajdarit, duke thënë se “nuk ka kurrfarë korrupsioni e keqpërdorimi”.

ZËVENDËSMINISTRI QORROLI PËRFAQËSON KOSOVËN NË TAKIMIN E NIVELIT TË LARTË TË “JUSTICE ACTION COALITION” NË MADRID

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, ka përfaqësuar Republikën e Kosovës në takimin e nivelit të lartë të “Justice Action Coalition (JAC)”, që po mbahet në Madrid, Spanjë, ku janë mbledhur ministra të drejtësisë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare dhe institucioneve të larta të drejtësisë nga mbarë bota.

Republika e Kosovës është anëtare me të drejta të plota e “Justice Action Coalition” që nga prilli i vitit 2023 dhe pjesëmarrja në këtë samit përbën një dëshmi të qartë të integritetit dhe kontributit të saj në rrjetet ndërkombëtare të drejtësisë.

Në fjalën e tij para përfaqësuesve të lartë të



vendeve anëtare, zëvendësministri Qorrolli theksoi se lufta kundër korrupsionit dhe ndërtimi i institucioneve të forta të drejtësisë janë shtylla themelore të qeverisjes demokratike, stabilitetit rajonal dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Ai

vuri në pah përparimin e Kosovës në sundimin e ligjit, duke u bazuar në të dhënat e World Justice Project, Transparency International dhe Freedom House, që e rendisin Kosovën ndër vendet me përmirësim më të madh në fushën e drejtësisë dhe qeverisjes demokratike në

rajon.

Zëvendësministri Qorrolli theksoi se, sipas Raportit Global të Sigurisë 2025 nga Gallup International, Republika e Kosovës është renditur ndër tre vendet më të sigurta në botë dhe vendi më i sigurt në Evropë, me një rezultat prej 94-pikësh nga 100. “Këto rezultate nuk janë thjesht statistika, ato janë pasqyrë e besimit të qytetarëve në ligj dhe në institucionet e sigurisë”, theksoi ai.

Duke folur për përfitimet nga nisma e Justice Financing Framework (JFF), Qorrolli shprehu bindjen se Kosova do të jetë ndër shembujt e parë në rajon që do ta zbatojë me sukses këtë kornizë, në mënyrë që drejtësia të shërbejë realisht për qytetarët dhe ta mbështesë zhvillimin gjithëpërfshirës social dhe ekonomik.

Në përmbyllje të fjalës së tij, ai

vlerësoi rolin e “Justice Action Coalition” si një platformë të fuqishme bashkëpunimi ndërkombëtar, ku shtetet anëtare ndajnë përvojat e tyre për ta bërë drejtësinë më të aksesueshme, më transparente dhe më të qëndrueshme. “Kosova e sheh ‘Justice Action Coalition’ si një aleancë të fuqisë së përbashkët, një hapësirë ku çdo shtet anëtar kontribuon në ndërtimin e një peizazhi global të drejtësisë më gjithëpërfshirës e më njerëzor,” u shpreh zëvendësministri Qorrolli.

Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës do të vazhdojë ta forcojë pjesëmarrjen dhe partneritetet ndërkombëtare në fushën e sundimit të ligjit dhe reformës në drejtësi, duke e pozicionuar Kosovën si një model i suksesshëm i reformave demokratike në Ballkanin Perëndimor.

GUVERNATORI ISMAILI MERR PJESË NË CEREMONINË E 100-VJETORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË, 12 NËNTOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, mori pjesë si folës në konferencën ndërkombëtare për nder të 100-vjetorit të Bankës së Shqipërisë, me temë “Një shekull banking qendror: Nga themelimi institucional te roli si ankorë rajonale”, organizuar nga Banka e Shqipërisë.

Konferenca trajtoi zhvillimet më të fundit në ekonominë globale, politikat monetare dhe rolin e bankave qendrore në kushtet e ndryshimeve të shpejta ekonomike e teknologjike, monedhat digjitale të qëndrueshme, pavarësinë monetare dhe të ardhmen e pasardhshme.

Guvernatori Ismaili mori pjesë si folës në panelin me temë “Monedhat digjitale të qëndrueshme, pavarësia dhe e ardhmja e pasardhshme”, ku në fillim uroi Bankën e Shqipërisë për 100-vjetorin e themelimit, duke e vlerësuar këtë përvjetor si një moment historik jo vetëm për institucionin, por edhe për sistemin financiar të rajonit në tërësi. Ai falënderoi Bankën e



Shqipërisë për bashkëpunimin e ngushtë dhe të qëndrueshëm me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në fjalën e tij, guvernatori Ismaili theksoi se evolucioni digjital po transformon mënyrën se si funksionojnë ekonomitë dhe shërbimet financiare, duke ndikuar drejtpërdrejt në përfshirjen financiare, efikasitetin e pagesave, forcimin e stabilitetit financiar dhe ruajtjen e integritetit monetar.

Guvernatori ndau reformat e ndërmarra nga Kosova në digjitalizimin e infrastrukturës së

pagesave, zgjerimin e qasjes në financa, zbatimin e suksesshëm të llogarisë bazike, si dhe nismat e tjera strategjike, si përafrimi me SEPA, zbatimi i projektit të pagesave të shpejta (TIPS Clone) si dhe zhvillime të tjera në pajtim me planin strategjik të BQK-së u pasqyruan më tej.

Në përmbyllje të fjalës, guvernatori Ismaili theksoi se inovacioni financiar duhet të ecë paralelisht me transparencën dhe edukimin financiar, ku stabiliteti financiar, sovraniteti monetar dhe integriteti i sistemit financiar, mbeten boshti i politikave tona.

SEKTORI I NDËRTIMTARISË SHËNON RITJE TË QËNDRUESHME TË TË HYRAVE




PRISHTINË, 12 NËNTOR - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se gjatë periudhës janar - tetor 2025 në sektorin e ndërtimtarisë janë realizuar 70.56 milionë euro të hyra tatimore krahasuar me 65.75 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Kjo paraqet një rritje prej 4.8 milionë euro ose 7.3 %, duke reflektuar përkushtimin e

bizneseve të këtij sektori dhe efikasitetin e masave të ATK-së për formalizim dhe përmirësim të përmbushjes tatimore.

Administrata Tatimore e Kosovës ka theksuar se do ta vazhdojë zbatimin e politikave që synojnë transparencë më të madhe, barazi tatimore dhe zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit.

DREJTORI I ATK-SË: DETYRË JONA ËSHTË TË RRYTITIM NJË BREZ QË TEKNOLOGJISË SË SOTME T'I JAPË NGJYRË ETIKE DHE MORALE



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Mentor Hyseni, mori pjesë në ceremoninë e shënimit të Ditës së Kontabilistëve, të organizuar nga Accell Accounting. Në fjalën e tij, Hyseni theksoi se që nga zbulimi i kontabilitetit para më shumë se gjashtë shekujsh, ky profesion ka kaluar nëpër shumë evolime e ndryshime

dhe, sipas tij, tash së fundi edhe me ndikimin e Inteligjencës Artificiale, e cila po transformon shumë profesione dhe mënyra pune. “Por ajo që nuk ka ndryshuar që nga koha e Paciollit, është etika dhe morali që kontabilistët i japin profesionit. Detyra jonë është të rrisim një brez që teknologjisë së sotme t'i japë ngjyrë etike dhe morale”, theksoi ai.

RRITET PJESËMARRJA E INDUSTRIISË PËRPUNUESE NË STRUKTURËN E PRODUKTEVE INDUSTRIALE

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Produkteve Industriale (PROD-COM) 2024. Sipas rezultateve të Anketës së Produkteve Industriale (PROD-COM) të vitit 2024, industria përpunuese (sektori C) vazhdon të mbetet sektori dominues në strukturën e produkteve industriale me 93.8 %, duke ruajtur të njëjtin nivel si në vitin 2023.



Industria nxjerrëse (Sektori B) në vitin 2024 ka shënuar rritje të lehtë prej 1.23 % krahasuar me vitin paraprak.

Ndërkohë, sektori i furnizimit me ujë, kanalizimit dhe menaxhimit të mbeturinave (Sektori E, kodi 3832) ka shënuar rritje të lehtë, nga 0.05 % në vitin 2022 në 0.88 % në vitet pasuese, duke treguar përmirësim të vazhdueshëm në aktivitetet ndihmëse të industrisë.

ASK-ja ka bërë përgatitjet e duhura për procesin “Peer Review”

Prishtinë, 12 nëntor - Përfaqësues të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) kanë pritur ekipin e ekspertëve të angazhuar nga Eurostat për vlerësimin e Sistemit Statistikor të Kosovës “Peer Review” 2025.

Ekipi ishte në përbërje të Jean-Michel Durr (kryesues, nga Franca), Tina Steenvoorden (anëtare nga Sllovenia), Pierre Bischoff (anëtar nga Eurostat), si dhe dy vëzhgues Liliana Mititiuc

nga Eurostat dhe Edin Šabanovic nga Bosnjë-Hercegovina). Misioni i ekspertëve për “Peer Review” do të qëndrojë në Kosovë gjatë gjithë javës.

ASK-ja si koordinatore e Sistemit Statistikor të Kosovës (ASK-BQK-MFPT) tashmë ka bërë përgatitjet e duhura për procesin “Peer Review” që është një proces mjaft të rëndësishëm i vlerësimit për integritim ndërkombëtar.

Vlerësimi i Sistemit Statistikor


të Kosovës përmes procesit “Peer Review” ka një rëndësi thelbësore për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë, besueshmërisë dhe saktësisë së statistikave zyrtare.

Në një kohë kur qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare mbështeten gjithnjë e më shumë në vendimmarrjen e bazuar në të dhëna, nevoja për një vlerësim të pavarur dhe rigoroz të sistemeve statistikore është bërë më e rëndësishme se kurrë.



MEDIAT SOCIALE KANË ‘VDEKUR’ DHE TELEVISIONI KA FITUAR

Pse e ardhmja është një e shkuar që e kemi parë tashmë



“Gjithçka që nuk është ende televizion, po bëhet televizion.” Kjo frazë e gazetarit amerikan Derek Thompson përmbledh një nga transformimet më të mëdha të epokës digjitale: mënyrën se si çdo formë komunikimi, nga rrjetet sociale te podcastet e deri te platformat e inteligjencës artificiale, po e kopjon gjithnjë e më shumë logjikën e televizionit. Spektakël. Ritëm i shpejtë. Konsum pasiv. Dominimi i videos ndaj fjalës. Kultura po kthehet sërish në shfaqje, dhe ekrani është skena e re universale.

Nga rrjetet sociale te televizionet personale

Kur Meta pranoi se vetëm 7% e kohës në Instagram kalon duke parë përmbajtje nga miqtë, ndërsa 93% shkon në video të panjohurish të zgjedhura nga algoritmi, u bë e qartë: Instagrami nuk është më një “rrjet social”. Është një transmetim i personalizuar, një kanal televiziv global i përshtatur për secilin prej

nesh.

TikTok, YouTube, Facebook... të gjitha janë kthyer në të njëjtën gjë: një ekran që rrëshqet pa fund, orë të tëra duke parë njerëz që nuk i njohim, në një rrjedhë të pafundme videosh. Rrjetet sociale lindën për të na lidhur, por sot shërbejnë për të mbushur heshtjen. Dhe nuk janë më komunikim. Ato janë anestezi dopaminergjike, një përkëdhelje e pandërprerë për sistemin tonë nervor që na mban zgjuar, por jo të vetëdijshëm.

Edhe inteligjenca artificiale do të bëhet televizion

As inteligjenca artificiale nuk i shpëton këtij “gravitacioni” të spektaklit. Meta ka lançuar Vibes, OpenAI ka prezantuar Sora: rrjedha të pafundme videosh të krijuara nga makinat, mini-filma pa autor, skena absurde që ekzistojnë vetëm për të mbushur hapësirën dhe kohën. Nuk është më njeriu që krijon. Është makina që argëton.

Televizioni si “tërheqës” i të gjithë mediave

Derek Thompson përdor një term matematik: tërheqës (attractor). Është pika drejt së cilës çdo sistem tenton të përfundojë, si një rruazë që rrotullohet në një tas derisa bie në qendër.

Në këtë kuptim, televizioni është tërheqësi i të gjithë mediave: çdo gjë përfundon në formatin dhe logjikën e tij. Raymond Williams e quajti këtë fenomen “rrjedhë” (flow): një vazhdimësi pa fillim e pa fund, ku përmbajtja rrotullohet pafundësisht, pa ndalesë dhe pa reflektim. Kur kultura humbet aftësinë për t’u ndalur, mbetet vetëm rrjedha. Dhe feed-i i rrjeteve sociale është lumi i ri i shenjtë i kësaj kohe.

Por ka një problem thelbësor: rrjedha nuk ndërton, ajo konsumon.

Kush ushqehet me kë?

Fjala feed në anglisht do të thotë ushqim. To feed — të ushqesh. Por pyetja që duhet

bërë është: A jemi ne që ushqehemi me feed-in, apo është feed-i që ushqehet me ne? Me kohën tonë, me të dhënat tona, me vëmendjen tonë. Sociologu Robert Putnam e paralajmëroi këtë që në vitet ‘90: nga 1965 deri në 1995, amerikanët fituan gjashtë orë më shumë kohë të lirë në javë. Dhe çfarë bënë me to? Ia dhanë televizionit.

Mund t’i kishin përdorur për të mësuar, për të dashur, për të krijuar, për të ndarë. Por i përdorën për të parë. Dhe sot historia po përsëritet.

Vetmia interaktive

Kemi më shumë lidhje se kurrë më parë, por jemi më të vetmuar se asnjëherë. Më shumë mundësi për të komunikuar, por më pak aftësi për të dëgjuar. Më shumë mjete për të krijuar, por më pak dëshirë për të menduar. Është vetmia interaktive: jemi të lidhur me të gjithë, por të sinkronizuar me askënd. Dhe televizioni, ai i vjetri apo ky i ri, po e amplifikon gjithçka. Logjika e tij është e thjeshtë:

Mos shpjego, emocion. Mos argumento, befaso. Mos mendo, reago.

Dhe kur gjithçka bëhet televizion, gjithçka bëhet spektakël. Politika bëhet teatër, shkenca bëhet tregim dhe informacioni bëhet performancë. Sa më shumë që përshtatemi me këtë logjikë, aq më shumë humbasim diçka të pazëshme: jo vetëm inteligjencën, por brendësinë. Aftësinë për të ndier nga brenda, jo nga jashtë, për të qëndruar të palëvizshëm. Për t’u mërzhitur. Në një botë ku gjithçka bëhet televizion, revolucionin e vërtetë është hapësira bosh, heshtja, ngadalësimi. Nuk do të fitojë ai që prodhon më shumë video, por ai që arrin ende të krijojë qetësi brenda zhurmës. Jo ai që mban shikimin ngjitur pas ekranit, por ai që di ta kthejë atë brenda vetes.

Bota nuk po bëhet më e paditur. Po bëhet televizive. Dhe në një botë televizive, ai që arrin ende të mendojë, ndoshta bëhet i padukshëm për algoritmin, por i domosdoshëm për realitetin. / bota.al

PO TË MOS ISHTE MËRZIA... DO TË ISHIM ENDE NJERËZ PRIMITIVË



Sado që mund të na duket një gjendje shpirtërore dytësore, në fakt, është e vështirë të imagjinojmë një botë pa mërzi. Arsyeja është e thjeshtë: mërzia është e lidhur ngushtë me mënyrën si funksionon truri ynë, veçanërisht me atë që quhet “rrjeti i parazitgjedhur”. Kur nuk po mendojmë për ndonjë gjë të veçantë, nuk kemi një qëllim për të ndjekur apo një parashikim për të bërë, truri ynë nuk fiket – përkundrazi, mendja jonë fillon të endet. Aktivizohet pikërisht ky rrjet neuronesh i shpërndarë në të gjithë trurin. Në fillim ky është një lloj çlirimi: të mos kesh një qëllim mund të jetë gjë e këndshme. Por nëse kjo gjendje e “mosbërjes” zgjat pak më shumë, shfaqet ajo – mërzia. Sipas teorive të shumë studiuesve, ndër të cilët edhe James Dankert i Universitetit të Waterloo-s (Kanada), funksioni i këtij emocioni të zakonshëm është të shërbejë si një rregullator i sjelljeve tona, duke na shtyrë drejt veprimit. Gjithçka varet nga lloji i mërzi: sipas psikologes evolucioniste Erin Westgate, mërzia që lind nga mungesa e stimulave na shtyn të bëjmë menjëherë diçka, ndërsa ajo që buron nga veprimtari monotone na nxit të kërkojmë më shumë larmi në atë që

bëjmë. Në thelb, bezdia që sjell mërzia na shtyn të lëvizim, të veprojmë, ose të paktën të qëndrojmë “të ndërlidhur” mendërisht. Madje edhe ata që e duan shumë çlodhjen, në fakt e mbushin me diçka: një libër për të lexuar, një seri televizive për të parë, një shëtitje në park... Një eksperiment i famshëm, përsëritur më vonë në Universitetin e Maastricht-it (Holandë), tregoi madje se shumë njerëz preferonin t'i jepnin vetes një goditje të lehtë elektrike sesa të vazhdonin të shikonin një video jashtëzakonisht të mërzitshme. Megjithatë, sipas psikologjisë, për ta “mposhtur” vërtet mërzinë nuk mjafton të bësh diçka – duhet të jetë një veprim që ka kuptim për atë që e bën.

Si do të ishte një botë pa mërzi?

Ndoshta do të ktheheshim në jetën e paraardhësve tanë gjuetarë, të cilët nuk kishin kurrë kohë për të qëndruar me duar në xhepa, sepse jeta e tyre varej nga kërkimi i përhershëm për ushqim, ndërprerë vetëm nga periudha të shkurtra gjumi. Por edhe ata, ndoshta, e kanë njohur ndonjëherë ndjesinë e mërzi, në ato ditë monotone

të kaluara duke bredhur në savanë në kërkim të diçkaje për të mbledhur.

Nëse sot do të jetonim në një botë pa mërzi, ndoshta do të ishim “copëza të çmendura” gjithmonë në lëvizje, njerëz që punojnë nga dëshira e vet deri në 15 orë në ditë. Nxënësit në shkollë do të ishin gjithmonë të vëmendshëm (ndërkohë që sot, sipas psikologes amerikane Gayle Macklem, mërzia përbën 30 deri në 50% të kohës që kalojnë në klasë). Por në një shoqëri të tillë hiperaktive nuk do të kishim më nevojë për filma, parqe zbavitjeje apo spektakle – pse do të duhej të “mbushnim kohën e lirë”, nëse koha e lirë nuk do të ekzistonte fare? Dhe, nëse do të ekzistonin prapë spektaklet, do të ishin gjithmonë të suksesshme, sepse askush nuk do t'i konsideronte më të mërzitshme. Një ëndërr për çdo artist!

... Ose ndoshta si zombi

Por mund të ndodhte edhe e kundërta. Nëse nuk do të ndienim kurrë mërzi, ndoshta do të ishim të pashpresë për nga dembelizmi: do të endeshim gjithë ditën si zombi, pa mendime në kokë dhe pa asnjë dëshirë për të bërë diçka, veçse për të

mbushur barkun deri në ditën tjetër.


Ndoshta peshkimi me grep do të ishte sporti më popullor – ndoshta i vetmi – sepse të presësh që peshku të kafshojë është diçka që do t'u pëlqente të gjithëve. Por një shoqëri e bazuar në mosveprim nuk do të kishte zgjatur shumë; nuk do të kishte evoluar, sepse mërzia është burim i inovacionit. Studimet tregojnë se mërzia nxit kreativitetin. Studentët që detyrohen të bëjnë detyra tepër monotone (si leximi i një liste telefonike) janë më krijues në zgjidhjen e problemeve matematikore, sesa ata që nuk janë mërzitur fare. Dhe mendo pak: shumë prej veprave të mëdha të historisë kanë lindur nga mërzia apo izolimi. Isaac Newton-i zhvilloi ligjet e gravitetit dhe optikës gjatë mbylljes së Universitetit të Kembrixhit për shkak të murtajës (1665). Në të njëjtin vit, John Milton filloi të shkruante “Parajsa e Humbur”. Anton Çehovi shkroi disa nga tregimet e tij më të njohura gjatë vetëizolimit për shkak të epidemive të kolerës në Rusi, ashtu si Pushkini që përfundoi “Eugene Onegin” në karantinë. Frida Kahlo filloi të pikturonte teksa ishte e shtrirë në shtrat pas aksidentit të saj tragjik në vitin 1925. Pa mërzinë e tyre,

ndoshta nuk do të kishim asnjë prej këtyre veprave.

Një efekt anësor pozitiv: më pak varësi

Një botë pa mërzi do të kishte ndoshta edhe një anë të mirë – zhdukjen e varësive. Studimet tregojnë se ata që kanë më shumë prirje për varësi (nga ushqimi, duhani, alkooli, lojërat apo drogat) janë ata që e përballojnë më pak mërzinë. Psikologu Marvin Zuckerman krijoi në vitet '90 “shkallën e ndjeshmërisë ndaj mërzi”, e cila mat intolerancën ndaj përsëritjes, rutinës, njerëzve parashikues dhe pritjes. Në krye të kësaj shkalle qëndrojnë ata që kërkojnë gjithmonë ndjesi të forta – “sensation seekers” – që shpesh kërkojnë rrezikun për të shmangur mërzinë.

Në një botë pa mërzi, pra, ndoshta do të zhdukeshin varësitë, por edhe sportet ekstreme, apo vrapimet me dema në Pamplonë. Sipas studimeve të Ofir Jakobi-t (Universiteti i Waterloo), njerëzit që mërzi të lehtë nuk janë thjesht adhures të rrezikut, por të pandjeshëm ndaj alternativave – ndaj, për të shmangur mërzinë, mund të zgjedhin edhe sjellje të rrezikshme, nëse nuk u ofrohet ndonjë alternativë më e sigurt. / Focus – Bota.al



KOSOVA NË PRAG TË HISTORISË: DY NDESHJE, DY VARIACIONE PËR ËNDRRËN E MADHE E QUAJTUR KUPA E BOTËS

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kombëtarja e Kosovës po hyn në fazën më emocionuese dhe vendimtare të kualifikimeve për Kampionatin Botëror 2026.

“Dardanët” do t’i zhvillojnë dy ndeshjet e fundit të Grupit B të cilat mund ta përcaktojnë fatin e tyre historik - pjesëmarrjen për herë të parë në “Play-Off”, ndoshta edhe në vetë Kupën e Botës.

Lajmi i mirë është se Kosova për dy përballjet e ka ekipin e plotë me lojtarët kryesorë që janë në formë optimale. Së pari, Kosova do të udhëtojë këtë të shtunë në Slloveni, për t’u përballur me një kundërshtar që kërkon ta shpëtojë nderin në grup. Katër ditë më vonë, më 14 nëntor, në “Fadil Vokrri” ekipi ynë do të përballlet me Zvicrën në një duel

që mund të vendosë gjithçka.

Në të njëjtin grup pritet të zhvillohen edhe dy ndeshje të tjera të rëndësishme: Zvicra do të përballlet me Suedinë këtë fundjavë, ndërsa katër ditë më vonë Suedia do të luajë ndaj Sllovenisë.

Situata është e qartë: me një barazim ndaj Sllovenisë, Kosova do ta siguronte matematikisht pjesëmarrjen në play-off, një arritje historike që do ta vendoste për herë të parë në mesin e kombëtareve më të mira të Evropës që luftojnë për një biletë Botërori.

Megjithatë, ekziston edhe një skenar - “më ëndërrimtar”, kualifikimi direkt në Kupën e Botës 2026. Për ta bërë këtë realitet, Kosova duhet të fitojë ndaj Sllovenisë dhe të shpresojë

që Zvicra të mos marrë tri pikë ndaj Suedisë.

Një epilog i tillë do ta hapte plotësisht grupin, duke e kthyer ndeshjen e fundit në “Fadil Vokrri” në një finale të madhe për historinë e futbollit të Kosovës.

Përzgjedhësi Franco Foda, në konferencën për shtyp para ndeshjes me Slloveninë, tha: “Në fillim kam thënë se çdo gjë do të jetë e hapur deri në fund. Çdo gjë është e mundur. Fokusi ynë është te ndeshja me Slloveninë. Synojmë të fitojmë të paktën një pikë, që ta sigurojmë pjesëmarrjen në play-off, më pas do të shohim tutje”, deklaroi ai.

Nën drejtimin e Fodës, Kosova ka treguar rritje të dukshme në performancë, disiplinë dhe



mentalitet garues. Fitoret ndaj Suedisë dhe barazimi ndaj Sllovenisë kanë rikthyer entuziazmin dhe besimin se kjo gjeneratë mund të bëjë diçka të madhe.

Nëse “Dardanët” arrijnë të sigurojnë “play-off”-in, apo

edhe më shumë, ky do të jetë një tjetër kapitull i artë në historinë e sportit të Kosovës - dëshmi e punës së madhe që është bërë në futboll vitet e fundit dhe e shpirtit luftarak që kjo skuadër ka treguar në çdo ndeshje.

DARDANËT U21 NISIN PËRGATITJET NË LARNAKA PËR DY SFIDAT E NËNTORIT

Prishtinë, 12 nëntor - Kombëtarja U21 e Kosovës ka nisur përgatitjet në Larnakë të Qipros për dy ndeshjet e rëndësishme kualifikuese për Kampionatin Evropian 2027, që do t’i zhvillojë si mysafirë ndaj Qipros dhe Finlandës.

Djelmohat e drejtuar nga trajneri Afrim Tovërlani kanë zhvilluar seancën e parë stërvitore në stadiumin “Dasaki Achnas”, ku atmosfera

brenda është tejet pozitive.

Përzgjedhësi Afrim Tovërlani theksoi se në këtë grumbullim ka tri prurje të reja dhe se dyert e kombëtares mbeten gjithmonë të hapura për lojtarë të rinj që e meritojnë ftesën me paraqitjet e tyre në fushë. “Atmosfera në ekip është shumë e mirë. Kemi disa lojtarë të rinj që janë bashkuar për herë të parë dhe janë integruar mirë në grup. Si



gjithmonë, përzgjedhjet bëhen në bazë të meritave dhe performancës. Qipro është një kundërshtar cilësor, por ne kemi ardhur për rezultat pozitiv dhe do ta japim maksimumin për ta arritur atë”, deklaroi Tovërlani.

Për Dren Zeqirin ky është grumbullimi i parë me Kombëtaren U21. Ai u shpreh i lumtur për pritjen që i është bërë nga bashkëlojtarët dhe

optimist për paraqitje të mirë. Ndërkaq, Eliot Bujupi theksoi rëndësinë e madhe që kanë ndeshjet kualifikuese për çdo futbollist të ri, duke shtuar se skuadra është e përgatitur dhe e motivuar për të vazhduar me rezultate pozitive.

Ndeshja ndërmjet Qipros dhe Kosovës U21 do të zhvillohet të premtën, më 14 nëntor, në orën 18:00 (sipas kohës së Kosovës).

DESCHAMPS DO TË LARGOHET NGA FRANCA, DËSHIRON TË DREJTOJË NË NIVEL KLUBESH



PARIS, 12 NËNTOR - Mandati i Didier Deschamps si trajner i kombëtares franceze do të përfundojë pas Kupës së Botës 2026 dhe tashmë ka interes nga klube të ndryshme për të pasuar atë.

Koha e trajnerit fitues të Botërorit në Francë po përfundon verën e ardhshme, dhe Deschamps synon ta

përsërisë triumfin e tij më të madh si trajner i Les Bleus, duke fituar Kupën e Botës 2018. Megjithatë, ai tashmë po planifikon një hap larg ekipit kombëtar dhe disa klube kanë shfaqur interesim për shërbimet e tij në nivel klubesh. Në një intervistë me ‘Telefoot’, Deschamps konfirmoi kontaktin me një klub saudit.

“Arrita të kontaktoj. Nuk do të përmend emra, por ata e dinë situatën time. Që nga momenti që mora një vendim dhe nuk do ta tërheq atë, kjo është e qartë. Do të jem i lirë pasi të kenë kaluar afatet dhe nuk do të jem i kufizuar në veprimet e mia”. Sipas ‘L’Equipe’, klubi i interesuar është Al Ittihad në Arabinë Saudite.

Aktualisht Sergio Conceição është në krye të Al Ittihadit, por klubi renditet në vendin e tetë pas tetë ndeshjesh dhe dyshimet për trajnerin portugez kanë filluar të qarkullojnë. Arritja e Deschamps në këtë skuadër pritet të sjellë një mentalitet fitues dhe përvojën e tij të pasur në garat më të larta ndërkombëtare.

Kualifikueset e Kupës së Botës, Kombëtarja shqiptare mbërrin në Andorra

TIRANË, 12 NËNTOR - Kombëtarja shqiptare ka udhëtuar të mërkurën drejt Andorrës në kuadër të ndeshjeve kualifikuese për Kupën e Botës 2026.

Departamenti i Komunikimit në FShF bën me dije se grupi i lojtarëve është i plotë dhe po të mërkurën do të jetë gati për ta zhvilluar stërvitjen zyrtare para ndeshjes me

Andorrën. Ndërkohë, trajneri Silvinjo dhe një lojtar i Kombëtares do të dalin para medieëve në konferencën zyrtare para ndeshjes së nesërme, të cilën mund ta

ndiqni drejtpërdrejt në FShF TV. Kombëtarja shqiptare do të përballlet të enjten me Andorrën në orën 20:45, ndeshje e vlefshme për Botërorin e vitit 2026.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Tree Solar L.L.C. me nr. të protokolit 5169/25 të datës 02.07.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet “Parku Solar Hybrid Tree Solar PV 85MWp dhe bateri 20MW” me infrastrukturën përcjellëse që ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Smallushë me numër të parcelave:

01340-4, 01258-1, 01258-3, 01258-5, 01340-3, 01340-8, 01340-1, 01340-5, 01340-6, 01340-7, 01338-2, 01337-3, 01258-2, 01258-6, 01258-7, 01337-2, 01337-1, 01266-0, 01258-8, 01338-1, 01340-9, në Komunën e Lipjanit.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e “Parku Solar Hybrid Tree Solar PV 85MW dhe bateri 20MW” për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.21.11.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:	
Kushtet Ndërtimore të propozuara: Tree Solar L.L.C. projekti-“ Parku Solar Hybrid Tree Solar PV 85MWp dhe bateri 20MW” Z.K. Smallushë - Komuna e Lipjani”	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 6, Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	m’
c. Vija e ndërtimit.	3 m 9 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5 m 3-9m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	5.7m 15 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	4.1 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	95.90 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	14
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Sofra e Vushtrris” SH.P.K. pronar Bajram Bajrami me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812229814 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Sofra e Vushtrris” D.O.O. Bajram Bajrami Vuqitern donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812229814 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Sofra e Vushtrris” L.L.C. with owner Bajram Bajrami with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812229814 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Eagle Design” SH.P.K. me seli në Glllogoc, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812167882 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Eagle Design” D.O.O. Glllogoc donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812167882 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Eagle Design” L.L.C. with headquarters Glllogoc, has come to the decision to quit its business: 812167882 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vl ada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Žvotne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A-KOSTT– Prishtinë me nr. të protokolit 1255/25 të datës 14.03.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet linja dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Rahovec dhe Zatriq P-71510057, me numër të parcelave: Z.K.Rahovec- 7509-0 ,7507-0,7504-0, 7097-0,6877-0, 6864-0, 6868-0, 6860-0, 6758-2, 6339-0, 6377-0, 4362-0, 4395-0, 4133-0, 3921-0, 3877-0, 3818-0, 3385-3, 3399-0 , 8716-0, 2851-0, 2852-0, 2881-0, 2279-0, 2288-28, 2288-27 ,2267-0, 2267-0, 2267-0, dhe ZK-Zatriq P-71510031 - 1279-0, 1277-0, 1276-0, 1269-0, 1147-0, 530-0, 1147-0,1128-0, 1119-0.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e “Linjës Ajrore 110kV- Parku me erë Zatriq 1&2” Z.K. Zatriq-Rahovec për përforcimin e rrjetit të bartjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.26.11.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:

Kushtet Ndërtimore të propozuara: Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu Sh.A-KOSTT– Prishtinë

Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:

a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 4,5, dhe 6 / Shfrytëzim i bartjes dhe shpërndarjes së energjisë	
b. Vija rregulluese.	15 - m’
c. Vija e ndërtimit.	- m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	31-35- m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	- m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	3 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	97 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	0
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese

I. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐


Nuk aplikohet ☐

m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth?
Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Armend Hasimja B.I nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër UNIK Identifikues: 810225989.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Xhelal Zherka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Arif Hasani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme ekonomike “Kadri Kusari”, drejtimi Hotelieri.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Vilhard Uka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Dëshmorët Lleshi” Doblibare Gjakovë nga kl.1-8.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Valbone Kodra shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 diplomën dhe certifikatën e maturës shtetërore sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Sabina Nrecaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.m.u “Anton Qeta” Dol Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- 3B Skele VEB SH.P.K. Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 812242824 të lëshuar nga ARBK.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE I NATIONAL AUDIT OFFICE

DATE PRANUAR DORËZUAR:
BARTUDOPIMI I DOKUMENTIT
DATE RECEIVED SUBMITTED

Nyrtësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Dr. Prot. Prot. No.	Nr. faqeve Dr. Stranica No. Pages
07/2	112	2029	1

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nationalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 01.09.2025 për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor junior për auditimin e performancës
Numri i pozitave: Një (1)
Numri i referencës: AJAP/ZKA/10-09/25

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin 2028 të datës 13.11.2025.

Prishtinë, 13.11.2025

Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna kancelarija revizije obaveštava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a dana 01.09.2025. godine, za radno mesto:

I. Položaj: Junior Revizor za reviziju učinka
Broj pozicija: Jedan (1)
Broj reference: AJAP/ZKA/10-09/25

Konkurs se otkazuje na osnovu odluke br. 2028 od datuma 13.11.2025

Priština, 13.11.2025

Departman za upravljanje ljudskim resursima

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN:
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L